



Partia Socialiste  
e Shqipërisë

Partia Socialiste e Shqipërisë

Tiranë, më 3 shkurt 2014

Zotit Ilir Meta, Kryetar i LSI

Zotit Lulzim Basha, Kryetar i PD

Zotit Shpëtim Idrizi, Kryetar i PDIU

Zotit Vangjel Dule, Kryetar i PBDNJ

Zotit Fatmir Mediu, Kryetar i PR

Zotit Nard Ndoka, Kryetar i PDK

Zotit Dashamir Shehi, Kryetar i LZHK

Të nderuar zotërinj,

Në emër të Partisë Socialiste, dëshiroj t'ju ftoj të kontribuojmë së bashku në mbështetjen e kandidaturës për Çmimin Nobel të Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi që së bashku me kandidaturën e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, Baroneshës Catherine Ashton dhe atë të Kryeministrit të Serbisë, Ivica Dačić, vlerësohen si protagonistët e një marrëveshjeje historike që çel rrugën e paqes mes dy shteteve të rajonit tonë, duke i dhënë fund historisë së gjatë të konflikteve në rajonin ku jetojmë.

Përgjatë një procesi sa të domosdoshëm për të ardhmen aq edhe të vështirë për të shkuarën, Kryeministri i Kosovës tregoi largpamësi të guximshme dhe vendosmëri të madhe, në dobi të interesit të lartë kombëtar, po edhe në dobi të një bote më të mirë. Marrëveshja e arritur ndërmjet Kryeministrit të Kosovës dhe Kryeministrit të Serbisë ishte, siç e cilëson me plot të drejtë Baronesha Ashton, "një hap më larg nga e kaluara dhe një hap më afër Evropës", për të dyja vendet. Prandaj për këtë kontribut kaq të rëndësishëm për krejt Evropën Juglindore, le të bashkojmë edhe ne zërin tonë me promovuesit e kësaj ideje.

Ja pse Ju propozoj ngritjen e një grupi të përbashkët deputetësh të të gjitha grupeve parlamentare, për hartimin e Letrës së Kuvendit të Shqipërisë drejtuar Kryetarit të Komitetit të Çmimit Nobel, Thorbjørn Jagland, në mbështetje të kandidaturës së Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, si Çmim Nobel për Paqen. Gjithashtu le t'i kërkojmë mbështetje grupeve respektive politike në Parlamentin Evropian, në asamblatë parlamentare të Këshillit të Evropës, OSBE e me radhë organizatat e tjera, me të cilat partitë tona bashkëpunojnë, për t'u shprehur në favor të nismës që promovon si kandidatë për Nobelin për Paqen, protagonistët e marrëveshjes së arritur mes Kosovës e Serbisë.

Me shpresën që ky propozim t'Ju gjejë të gjithëve dakord, përfitoj nga rasti për t'Ju uruar punë të mbarë!



Edi Rama

Kryetar i Partisë Socialiste